



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2456/2 Prot

Rrëshen më, 25 . 06 . 2024

V E N D I M

Nr. 57 datë 24. 06. 2024

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 12, DATË 31.01.2024, TË KËSHILLIT BASHKIAK
“PËR MIRATIM E PAGESËS SË QIRASË, PËR NJË PERIUdhË 1 (NJË) VJEÇARE
SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR FAMILJET E PASTREHË”, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligji nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, VKM nr. 301, datë 25.04.2020, “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banasat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, VKM nr. 362, datë 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes së tij”, VKM nr. 459, datë 03.07.2019, “Rregullat mbi administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzurfuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM nr. 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, relacionin nr. 2456 prot, datë 19.06.2024, së bashku me projekt-vendimin e kryetarit të bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve në seancë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë pagesën e plotë të qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare, sipas vlerës së tregut për familjet e pastreha, bashkia Mirditë, lista emërore e përfituesve, me numër rendor nga; 1-6 (një deri në gjashtë) përfitues, bashkëlidhur, relacioni nr. 2456, prot, datë 19.06.2024 dhe tabelat, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pagesa për familjet e pstreha do të realizohet nga buxheti i shtetit (Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit) nga muaji Janar - Dhjetor 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (drejtoria e planifikimit, zhvillimit të territorit dhe strehimit).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor. nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër RICA KU

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2456/prot.
1

Rrëshën 19.06.2024.

P/VENDIM

Nr. 66 Datë 19.06.2024

PËR

**“ NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 12 DATË 31.01.2024 TË KËSHILLIT
BASHKIAK MIRDITË ‘PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË PËR NJË
PERIUDHË 1(NJË) VJEÇARE SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR FAMILJET E
PASTREHË’”, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, Vkm nr. 301, datë 25.04.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standartet për banasat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vkm nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyren e llogaritjes së tij, Vkm nr. 459, datë 03.07.2019 “Rregullat mbi administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzurfuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Vkm nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozim të kryetarit të bashkisë, këshilli bashkiak pas diskutimeve;

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e plotë të qirasë për një periudhë 1 (një) vjeçare, sipas vlerës së tregut për një shtesë për familjet e pastreha, bashkia Mirditë, lista emërore e përfituesve, me numër rendor nga; 1-6, (një deri në gjashtë), bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pagesa për familjet e pstreha do të realizohet nga buxheti i shtetit (Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit) nga muaji Janar-Dhjetor 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (Drejtoria Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave dhe drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit, të Territorit).

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

SEKRETAR

Gasper TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksandër PICA KU

Paraqitën Projektin:

Dr. Planifikimit, Zhvillimit të Territorit : Sp. O. GJIKOLAJ

Drejtor: Ing G. VLADI

Dr. Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Marrëdhënieve me Qytetarët: Juriste/ M.DODA

KRYETARI

Albert MËLYSHI



Tabela Nr. 4 Llogaritja e masës së subvencionimit të qirasë

Nr.	Emër, Atësia, Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018	Përb familje	Struktura e apart.	Sipërfaqja e apart. (m2)	Qiraja mes. e treg per strukturen që i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nenit 2, të ligjit 22/2018)	Aftësia përballue se sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja e përballuar (g*)	Subvencioni në muaj (g-k)	Subv/uaj që mbulohet nga BM	Shuma që kerkohet nga buxheti i shtetit
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Zef Mark GJOKA	Kryef, I divorc, Pens, PAK	1	1+1	30	12,600	-	Pa te ardhura	15%	-	12,600	-	12,600
2	Dilë Zef LEGISI	Kryef, Pens, e ve, Invalid	2	1+1	30	12,600	15,964	Të ardhura sh të ulëta	15%	2,395	10,205	-	10,205
3	Besnik Gjetë Gjoka	Kryef, I divorc, Nd.ek	1	1+1	30	12,600	-	Pa të ardhura	15%	-	12,600	-	12,600
4	Fatjon Gjon TURUKU	Kryef,	5	2+1	50	15,400	-	(sipas pikës 25, e nenit 2, të ligjit 22/2018)	15%	-	15,400	-	15,400
5	Edmond Ndue MARKU	Kryef	4	2+1	50	15,400	38,000	Të ardhura sh të ulëta	15%	5,700	9,700	-	9,700
6	Arjana Vlash LOSHI	Kryef, E ve	3	2+1	50	15,400	-	Pa te ardhura	15%	-	15,400	-	15,400
	TOTALI					84,000					75,905		75,905

Sp. Sek/Strehimit: Oriela GJIKOLAJ

Drejtori: Ing. Genc VLADIMIRI

KRYETARI

Albert MËLYSHI





G.T

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2456 prot.

Rrëshën 19.06.2024.

RELACION

PËR P/VENDIMIM

“PËR NJË SHITESËNË NË VENDIMIN NR. 12 DATË 31.01.2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË PËR NJË PERIUdhË 1(NJË) VJEÇARE SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR FAMILJET E PASTREHË”, BASHKIA MIRDITË.

Të nderuar këshilltarë,

Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale në tregun e lirë. Bazuar në vlerësimin e nevojave për strehim dhe mundësitë financiare për të mbështetur me fonde këtë program që aplikon Bashkia Mirditë për familjet e pastreha pa të ardhura ,me të ardhura të ulëta, shumë të ulëta zbatohet në bashkëfinancim me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit sipas përcaktimeve për kufinj të financimit sipas Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për Programet e Strehimit”, ku thuhet që, financimi nga buxheti i shtetit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të bëhet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV. Nga aplikimet që janë bërë në listojmë 6 familje që janë në plotësim të kriterëve të përcaktuara në nenin 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.Sipas përcaktimeve për qiranë e përballueshme të cilën familja arrin ta paguajë vetë me të ardhurat e veta janë vlerësuar për të përfituar bonusin e strehimit në masë të plotë ose të pjesshme sipas kushteve të secilit aplikant. Këto familje me nr rendor nga 1-6 (një deri gjashtë) janë trajtuar me bonus deri në dhjetor të vitit 2023 dhe për mungesë dokumentacioni, kërkojmë fond nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit duke qënë se janë në kushte të vështira ekonomike dhe të pastrehe, dhe familja me nr.rendor 5 është kërkesë e re dhe familja do të trajtohet dhe kërkohet fond për muajt Qershor-Dhjetor 2024, prandaj këkohet një shtesë në

**“ VENDIMIN NR. 12 DATË 31.01.2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË
“PËR MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË PËR NJË PERIUDHË 1(NJË)
VJEÇARE SIPAS VLERËS SË TREGUT, PËR FAMILJET E PASTREHË”,
BASHKIA MIRDITË.**

Paraqesim një përshkrim të shkurtër mbi këto 6 (gjashtë) familje si më poshtë vijon :

- 1- Zef Mark GJOKA, Kryefamiljar, I divorcuar, kategoria Invalid pune i plotë, Pensionist , 1 anëtarë në çertifikatë. Struktura që përfiton është 1+1 ku vlera e qirasë mujore për këtë strukture është 12.600 lekë , sipas të dhënave në tabelën bashkangjitur.
- 2- Dilë Zef Legisi, Kryefamiljare, Pensioniste , I/e ve, 2 antarë në çertifikatë familjare, Trajtohet me invalidiet të plotë i biri, Struktura që përfiton 1+1 me vlerë të qirasë mujore 12 600 lekë, sipas të dhënave në tabelën bashkangjitur.
- 3- Besnik Gjetë Gjoka, Kryefamiljar, i divorcuar ,1 person në çertifikatë, trajtohet me ndihmë ekonomike 2100 lekë në muaj, Struktura që përfiton 1+1, Vlera e qirasë mujore 12.600 lekë.
- 4- Fatjon Gjon TURUKU, Kryefamiljar, 5 persona në çertifikatë, Pjesë përbërese e pikes 25 neni 2 të ligjit 22/2018 Për Strehimin; pika 25 të nenit. “Kushte emergjence për strehim” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe në banesat që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilët nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit.
- 5- Edmond Ndue Marku, Kryefamiljar, 4 persona në çertifikatë, i pastrehë, me të ardhura shumë të ulëta, sipas të ardhurave për frymë, struktura që përfiton 2+1 me vlerë 15400, Pagesa do ti bëhet nga momenti i kërkesës së protokolluar Qershor-Dhjetor 2024
- 6- Arjana Vlash Loshi, Kryefamiljare, e ve, në listën e të pastrëhëve ndër vite, 3 persona në çertifikatë, pa të ardhura, struktura që përfiton 2+1 me vlerë mujore 15400 sipas të dhënave në tabelën bashkëngjitur.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin!

Sp/ Sektorit të Setrehimi

Oriela GJIKOLAJ



KRYETARI

Albert MËLYSHI

